

PLANI SOCIAL VENDOR

BASHKIA DELVINË

2025-2028



Funded by
the European Union

Ky Plan Social Vendor është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Ky Plan Social Vendor publikohet nëpërmjet Asistencës Teknike “Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (EU4SI), të dhënë nga Bashkimi Evropian për Bashkinë e DELVINË, zbatuar nga GOPA Worldwide Consultants.

Shkurtime

AK	Aftësi të Kufizuara
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizat Jo Qeveritare
PAK	Person me Aftësi të Kufizuara
NE	Ndihmë Ekonomike
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës
NJVRN	Njësia Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave
PSV	Plani Social Vendor
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UM	Urdhër Mbrojtje

Contents

I.Hyrje	4
II. Metodologjia për Hartimin e Planit	4
III. DIAGNOZA	6
1. Diagnoza për kategoritë në nevojë.....	6
2. Diagnoza e shërbimeve shoqërore	17
3. Diagnoza për Burimet Njerëzore në Shërbimet Sociale në Bashkinë DELVINË	19
4. Përmbyllje e diagnozës së Planit Social Vendor në Bashkinë DELVINË	20
5. Analiza SWOT	21
IV. Vizioni, Misioni , Prioritetet Strategjike dhe Objektivat	22
V. Plani i Veprimit	Error! Bookmark not defined.
VI. Finalizimi i Planit Social Vendor.....	Error! Bookmark not defined.
VII. Monitorimi dhe Vlerësimi(1–2 faqe).....	46
VIII Shtojca.....	48
Shtojca 1 Kuadri legjislativ.....	48
Shtojca 2 Persona burimorë dhe profesionistë lokale për mbrojtjen sociale në nivel bashkie dhe njësisish administrative	49
IX ANEKSE	49

I.Hyrje

Plani Social Vendor i Bashkisë Delvinë për periudhën 2025–2028 përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi mbrojtjeje sociale gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të orientuar nga nevojat reale të komunitetit. Ky plan strategjik trevjeçar është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjitë kombëtare, përfshirë Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030. Ai shënon përkushtimin e Bashkisë Delvinë për të ofruar shërbime më cilësore dhe akses të barabartë për çdo qytetar.


Dokumenti është ndërtuar mbi një diagnozë të thelluar të situatës sociale dhe një proces të hapur e gjithëpërfshirës, me pjesëmarrjen aktive të institucioneve vendore, organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit. Bashkia Delvinë, si një nga gjashtë bashkitë pilote në nivel kombëtar që morën pjesë në hartimin e guidës së re për planet sociale vendore, me mbështetjen e projektit të asistencës teknike të zbatuar nga GOPA, ka fituar përvojë dhe aftësi të reja për të ndërtuar politika sociale të bazuara në evidenca dhe të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

E vendosur vetëm 15 minuta nga Saranda dhe e përbërë nga dy njësi administrative – Delvinë dhe Vergo – Bashkia Delvinë shquhet për potencialin e saj turistik, historik dhe bujqësor. Megjithëse përballet me sfida të lidhura me kapacitetet e kufizuara financiare dhe njerëzore, bashkia ka treguar vullnet dhe angazhim të qartë për të hartuar dhe zbatuar politika sociale inovative, të cilat mbështesin grupet më vulnerabël dhe kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë komunitetin.

II. Metodologjia për Hartimin e Planit

Metodologjia për hartimin e Planit Social Vendor të Bashkisë DELVINË është ndërtuar mbi parimet e pjesëmarrjes, bazimit në të dhëna dhe orientimit drejt rezultateve, në përputhje me 'Guidën Kombëtare për Hartimin e Planit Social Vendor 2025'. Procesi është strukturuar në tre faza kryesore që kanë mundur përfshirjen e gjerë të aktorëve lokalë dhe përdorimin e instrumenteve të standardizuara.

Fig 1 Tri fazat kryesore të metodologjisë për hartimin e Planit Social Vendor



Faza I:

- ❖ U krijua Komiteti Drejtues dhe Grupi Teknik me përfaqësues nga bashkia dhe institucionet lokale si AKPA, ZVA, ISSH, Drejtoria Rajonale e SHSSH, etj.
- ❖ U hartua harta e aktorëve dhe u ndërtua një bazë e dhënash për shërbimet ekzistuese.
- ❖ U realizuan 7 intervista me drejtues institucionesh për të identifikuar boshllëqet dhe mundësitë për përmirësim.
- ❖ U zhvilluan 5 fokus grupe në qytet dhe në njësi administrative, me përfitues dhe jo-përfitues të shërbimeve.
- ❖ U grumbulluan të dhëna statistikore dhe dokumentare nga burime vendore dhe qendrore.

Faza II:

- ❖ Të dhënat u analizuan përmes mjeteve vizuale dhe analizës SËOT për çdo kategori vulnerabël.
- ❖ U organizua një seminar konsultativ me rreth 50 pjesëmarrës për të diskutuar prioritetet sociale.
- ❖ U hartua dhe u miratua raporti diagnostikues nga grupi teknik dhe Komiteti Drejtues.
- ❖ Të dhënat krahasuese për periudhat 2022 dhe 2024 u përdorën për të mbështetur analizën.

Faza III:

- ❖ U ndërtuan fletëveprimi për çdo objektiv specifik, duke përfshirë aktivitete, tregues, burime dhe partnerë.
- ❖ U zhvilluan takime me Komitetin Drejtues, Grupin teknik për planifikimin buxhetor dhe afatet trevjeçare.
- ❖ U organizua takim me donatorë dhe OJF për të diskutuar mundësitë e bashkëfinancimit.
- ❖ Plani u miratua nga Këshilli Bashkiak dhe u prezantua për komunitetin për transparencë.

Qasje metodologjike

- Përdorimi i një strukture të testuar në 5 bashki të tjera.
- Instrumente të standardizuara për mbledhjen, analizën dhe dokumentimin e të dhënave.
- Pjesëmarrje e gjerë me rreth 166 individë përmes intervistave, fokus grupeve dhe aktiviteteve konsultative.

Fig 1 Pjesëmarrja në procesin konsultativ për hartimin e Planit Social Vendor




Figura 1 paraqet përfshirjen e aktorëve lokalë në fazat kyçe të procesit të hartimit të planit, duke reflektuar angazhimin e Komitetit Drejtues, Grupit Teknik dhe komunitetit lokal përmes fokus grupeve dhe seminarit konsultativ.

III. DIAGNOZA

Ky dokument përmbledh tre diagnoza kryesore të realizuara në kuadër të Planit Social Vendor të Bashkisë DELVINË:

1. Diagnozën për kategoritë në nevojë,
2. Diagnozën për shërbimet shoqërore,
3. Diagnozën për burimet njerëzore të strukturave të shërbimeve sociale.

1. Diagnoza për kategoritë në nevojë

Bashkia Delvinë përballet me sfida të dukshme demografike që ndikojnë drejtpërdrejt në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Një analizë e të dhënave të Censit 2023 dhe Regjistrit Civil 2024 ofron një panoramë të qartë të ndryshimeve strukturore të popullsisë.

Sipas Censit 2023, Bashkia Delvinë ka një popullsi rezidente prej 6,166 banorësh, me një rënie rreth 20% krahasuar me vitin 2011. Kjo rënie reflekton emigracion të lartë dhe plakje të popullsisë. Ndërkohë, sipas Regjistrit Civil (dhjetor 2024), popullsia rezultoi 17,250 banorë, duke krijuar një diferencë të konsiderueshme me të dhënat e Censit. Kjo tregon për një numër të madh personash të regjistruar, por që nuk jetojnë realisht në territor.

Popullsia është e përqendruar në njësinë Delvinë (4,952 banorë), ndërsa Vergo ka 1,214 banorë. Struktura gjinore është e balancuar (50.4% meshkuj, 49.6% femra). Nga pikëpamja e grupmoshave, popullsia mbi 65 vjeç përbën 26.7%, dhe fëmijët 0–14 vjeç vetëm 11.4%, çka konfirmon profilin demografik të plakur dhe nevojën për fokus të veçantë në shërbimet për të moshuarit.

Nga ana tjetër, numri i familjeve ka pasur një rritje të lehtë nga viti 2022 në 2024, ndonëse popullsia totale e regjistruar ka pësuar rënie, duke sugjeruar rritje të numrit të familjeve të vogla ose të vetmuara.

Këto të dhëna tregojnë qartë se Bashkia Delvinë ka nevojë për politika të mirëfillta sociale që adresojnë këto ndryshime demografike. Trendet e vëzhguara kërkojnë një qasje të integruar për planifikimin e shërbimeve, përmes fokusit tek një popullsi që po plakët, përfshirjes më të mirë të zonave rurale dhe përdorimit të të dhënave të sakta për vendimmarrje efektive.

1.1 Diagnoza për familjet në nevojë

Familjet në nevojë përbëjnë një nga kategoritë prioritare për ndërhyrje në fushën e mbrojtjes sociale në Bashkinë Delvinë. Këto familje përballen me vështirësi të theksuara ekonomike, mungesë akses në shërbime dhe përjashtim social, veçanërisht në rastet kur në përbërje të tyre ka gra kryefamiljare, anëtarë me aftësi të kufizuar, të moshuar ose fëmijë në rrezik. Analiza më poshtë synon të identifikojë karakteristikat kryesore të këtyre familjeve, mbulimin e tyre me shërbime dhe nevojat për ndërhyrje të mëtejshme.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Familjet në nevojë në Bashkinë Delvinë përbëhen kryesisht nga njësi familjare me të ardhura të pamjaftueshme ose pa të ardhura, të cilat varen nga skemat e ndihmës ekonomike apo nga mbështetja sezonale. Ato përfshijnë kategori të ndryshme vulnerabël si gra kryefamiljare, persona të moshuar, anëtarë me aftësi të kufizuar, vajza-nëna, si dhe familje nga komuniteti rom dhe egjiptian. Shumë prej këtyre familjeve përballen me mungesë strehimi adekuat, mungesë punësimi dhe izolim social. Emigracioni është një faktor i rëndësishëm që ka ndikuar në reduktimin e popullsisë dhe fragmentimin e strukturës familjare, duke shtuar numrin e familjeve të vogla dhe të vetmuara në vështirësi ekonomike.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Në vitin 2024, Bashkia Delvinë numëronte 6,332 familje sipas Regjistrimit Civil. Nga këto, vetëm 156 familje janë familje në nevojë dhe përfitojnë pagesa mujore në CASH nga skemat mbrojtjes sociale (150 nga skema e Ndihmës Ekonomike dhe 6 familje nga fondi 6%). Kjo shifër përfaqëson më pak se 2.5% të totalit të familjeve në bashki. Brenda këtij grupi: 408 individë jetojnë në familje me ndihmë ekonomike (rreth 6.6% e popullsisë sipas Censit 2023); 42 familje kanë gra kryefamiljare, 18 prej tyre me anëtarë me aftësi të kufizuar; 8 raste janë vajza-nëna; 14 familje janë rome dhe egjiptiane; 5 familje kanë të gjithë anëtarët në moshë pensioni; 63 familje janë në vështirësi vetëm për arsye ekonomike.

Gjithashtu, janë identifikuar 2 fëmijë në kujdestari, 2 persona me status jetimi dhe vetëm 1 rast i dhunës në familje. Megjithatë, këto të dhëna përfaqësojnë vetëm pjesërisht realitetin, pasi nuk ekziston një sistem i integruar për identifikimin dhe kategorizimin gjithëpërfshirës të familjeve në nevojë. Mungojnë gjithashtu të dhëna të detajuara për papunësinë dhe formimin profesional. AKPA nuk gjeneron statistika të ndara për Bashkinë Delvinë, dhe pjesa më e madhe e punësimit ndodh në sektorin informal dhe sezonalisht në zonat përreth Sarandës.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Shërbimet sociale të strukturuar për familjet në nevojë mungojnë në territorin e Bashkisë Delvinë. Mbështetja kufizohet në skemat financiare (NE dhe fondi 6%) dhe shërbimet parashoqërore që ofrohen nga administratorët shoqërorë në terren. Nuk ka qendër komunitare, programe këshillimi apo ndërhyrje të specializuara për përmirësimin e mirëqenies së familjes. Po ashtu, nuk ofrohen shërbime për strehim, përveç mbështetjes sporadike për rikonstrukcion banese, për të cilin mesatarisht aplikojnë 22 raste çdo vit.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Bazuar në situatën e paraqitur, Bashkia Delvinë duhet të ndërmarrë hapat e mëposhtëm për përmirësimin e mbështetjes ndaj familjeve në nevojë:

Krijimi i një regjistri funksional të familjeve në nevojë, përtej përfituesve të ndihmës ekonomike;

- ✓ Zhvillimi i një profili të detajuar të rrezikut për familjet vulnerabël, për të mundësuar ndërhyrje të diferencuara;
- ✓ Ngritja e një qendre komunitare me funksione multidisiplinare për këshillim, orientim punësimi dhe mbështetje për prindërimin;
- ✓ Zhvillimi i partneriteteve me OJF dhe donatorë për ofrim shërbimesh komunitare dhe ndërhyrje të targetuara;
- ✓ Mbështetje për strehimin, përmes fondeve të posaçme për rikonstrukcion dhe/ose subvencione për qira;
- ✓ Trajnimi i administratorëve shoqërorë për të rritur kapacitetin e identifikimit dhe menaxhimit të rasteve komplekse.

Në Bashkinë Delvinë, familjet në nevojë përballen me vështirësi të theksuara ekonomike dhe sociale, që shpesh mbeten jashtë mbulimit nga mekanizmat ekzistues të mbrojtjes sociale. Mbështetja aktuale kufizohet në ndihmën financiare, ndërsa mungojnë shërbimet e strukturuar dhe qasja ndërsektoriale për të adresuar nevojat komplekse të këtyre familjeve. Kategori të brishta si gra kryefamiljare, vajza-nëna, familje me anëtarë me aftësi të kufizuara apo nga komuniteti rom dhe egjiptian përballen me përjashtim të shumëfishtë dhe mbështetje të pamjaftueshme. Mungesa e të dhënave të detajuara, kapaciteteve lokale dhe strukturave si qendra komunitare e rëndon më tej situatën. Kjo diagnozë nënvizon nevojën për identifikim gjithëpërfshirës, shërbime të aksesueshme dhe ndërhyrje të integruara që synojnë përmirësimin e qëndrueshëm të mirëqenies së familjeve në nevojë.

1.2 Diagnoza për Personat me AK

Diagnoza për Personat me Aftësi të Kufizuar (PAK) në Bashkinë Delvinë synon të evidentojë sfidat dhe boshllëqet ekzistuese në sistemin e mbështetjes për këtë kategori, bazuar në të dhënat e vitit 2024 dhe analizën e terrenit. Kjo diagnozë shërben si bazë për hartimin e politikave vendore gjithëpërfshirëse dhe për zhvillimin e shërbimeve sociale të integruara.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Personat me aftësi të kufizuar (PAK) në Bashkinë Delvinë përbëjnë një kategori të konsiderueshme të popullsisë, e përfaqësuar nga profile të ndryshme të aftësisë së kufizuar si: invalidë, të verbër, para/tetraplegjikë dhe PAK të tjerë. Shpërndarja e tyre është e përqendruar kryesisht në njësinë Delvinë, ndërsa një pjesë më e vogël jeton në njësinë Vergo. Kjo kategori përballlet me mungesë aksesimi në shërbime sociale të strukturuar, mbështetje të fragmentuar dhe mungesë të qasjes së integruar për edukim, rehabilitim dhe përfshirje në jetën komunitare.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Në vitin 2024, rezultojnë 487 persona me aftësi të kufizuar që përfitojnë pagesë për shkak të AK. Shumica e tyre janë invalidë, ndjekur nga PAK të tjerë, të verbër dhe para/tetraplegjikë. 22 janë fëmijë me AK, shumica me aftësi të kufizuara mendore. Vetëm një pjesë e vogël përfiton nga shërbimi i ndihmësit personal (64 persona) dhe shumë pak janë të përfshirë në sistemin arsimor. Mungojnë të dhënat për pjesëmarrjen në kopsht/çerdhe dhe përfshirjen në formim profesional apo punësim. Kjo tregon për një boshllëk të madh në evidentimin, ndjekjen dhe monitorimin e nevojave të PAK në të gjitha ciklet e jetës.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Aktualisht, Bashkia Delvinë nuk ofron shërbime sociale të strukturuar për PAK. Mbështetja kufizohet në skemat financiare, shërbimin e ndihmësit personal dhe asistencën nga administratorët shoqërorë në formë parashoqërore. Mungojnë shërbimet rehabilituese, terapistë profesionale dhe ato ditore. Nuk ekzistojnë OJF që ofrojnë shërbime të qëndrueshme për këtë kategori; përjashtimisht, Motrat Franceskane ofrojnë ndihma sporadike, jo të strukturuar. Bashkëpunimi me operatorin lokal të kujdesit shëndetësor mbetet potencial i pashfrytëzuar për zhvillimin e një mekanizmi për mbështetje në banesë për PAK me lëvizshmëri të kufizuar.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Bazuar në analizën e të dhënave, PAK në Bashkinë Delvinë kanë nevojë për:

- ✓ ndërtimin e një qendre ditore me shërbime rehabilituese dhe sociale;
- ✓ zhvillimin e databazës së përditësuar nevojat e PAK;
- ✓ përfshirje në arsimin e hershëm, në formimin profesional dhe në jetën publike;
- ✓ ngritjen e një mekanizmi bashkëpunimi ndër-institucional për ofrimin e shërbimeve në shtëpi për PAK me lëvizshmëri të kufizuar.

Analiza tregon se personat me aftësi të kufizuar në Bashkinë Delvinë mbeten të pambuluar nga shërbime sociale të strukturuar, përballen me mungesë qasjeje në arsim dhe rehabilitim, dhe përjashtohen nga programe të formimit profesional dhe përfshirjes në komunitet. Kjo situatë kërkon angazhim të menjëhershëm institucional për zhvillimin e shërbimeve ditore, rritjen e aksesit në mbështetje të personalizuar dhe ndërtimin e një mekanizmi bashkëpunues ndërinstitutional për mbështetje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

1.3 Diagnoza e fëmijëve në rrezik

Fëmijët përbëjnë një kategori prioritare në kuadër të mbrojtjes sociale në Bashkinë Delvinë, duke kërkuar një vëmendje të veçantë për shkak të sfidave të shumta që lidhen me edukimin, mbrojtjen, shëndetin dhe përfshirjen sociale. Kjo diagnozë bazohet në të dhënat e viteve 2022 dhe 2024 dhe synon të evidentojë gjendjen aktuale, boshllëqet dhe nevojat prioritare për ndërhyrje.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Fëmijët përbëjnë një pjesë të vogël të popullsisë në Bashkinë Delvinë, duke reflektuar qartë prirjen demografike të plakjes së popullsisë dhe rënies së lindshmërisë në këtë zonë. Ky grup përballen me një sërë sfidash që lidhen me braktisjen e shkollës, dhunën në familje apo komunitet, përfshirjen e kufizuar në arsimin parashkollor, si dhe mungesën e shërbimeve të specializuara për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre. Ndër grupet më të cenueshme përfshihen fëmijët e komuniteteve romë, fëmijët që jetojnë me një prind të vetëm, fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe fëmijët që jetojnë në familje përfituese të ndihmës ekonomike. Për të kuptuar më mirë nevojat e këtij grupi dhe për të orientuar ndërhyrjet e duhura, është e rëndësishme të analizohen të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet që karakterizojnë situatën e fëmijëve në nivel vendor.

Sipas Censit 2023, në Bashkinë Delvinë jetojnë gjithsej 6,166 banorë, nga të cilët vetëm 705 janë fëmijë të moshës 0–14 vjeç, duke përfaqësuar vetëm 11.4% të popullsisë. Ky tregues konfirmon prirjen drejt plakjes së popullsisë dhe rënies së lindshmërisë në nivel lokal. Të dhënat arsimore tregojnë për një numër të ulët fëmijësh të përfshirë në sistemin arsimor: 18 fëmijë ndjekin çerdhen, 156 janë të regjistruar në kopshte, 538 në arsimin bazë dhe vetëm 177 në shkollën e mesme. Në territor funksionon vetëm një çerdhe publike.

Sa i përket fëmijëve në situatë vulnerabël, janë identifikuar 111 raste që i përkasin kategorive të ndryshme në nevojë. Ndër to përfshihen fëmijë me aftësi të kufizuar (22 raste, nga të cilët vetëm 7 ndjekin shkollën), fëmijë në konflikt me ligjin (14 raste), fëmijë të dhunuar (3 raste), si dhe 28 fëmijë romë të përfshirë në sistemin arsimor. Të dhënat tregojnë gjithashtu prani të fëmijëve që jetojnë në familje me ndihmë ekonomike, me një prind të vetëm, ose në kujdestari alternative.

Boshllëqet kryesore lidhen me mungesën e një sistemi të strukturuar për identifikimin dhe monitorimin e fëmijëve në rrezik, mungesën e aksesit në shërbime psikologjike, sociale

dhe rehabilituese, si dhe mungesën e strukturave mbështetëse për fëmijët me nevoja të veçanta.

Të dhënat e detajuara për fëmijët në nevojë:

Kategori të fëmijëve në nevojë	Total	Vajza	Djem
Fëmijë të dhunuar (2 vajza)	3	2	1
Fëmijë që braktisin shkollën	2	1	1
Fëmijë në familje me NE	53	23	30
Fëmijë me një prind	13	5	8
Fëmijë në familje kujdestare	2	2	0
Fëmijë me status jetimi	2	1	1
Fëmijë me AK	22	8	14
Fëmijë në konflikt me ligjin	14	6	8
Total	111	48	63

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Në Bashkinë Delvinë, mbështetja sociale për fëmijët është e kufizuar dhe e paorganizuar në forma të strukturuar. Aktualisht, mungojnë qendrat komunitare, shërbimet ditore dhe programet rehabilituese apo edukative që adresojnë nevojat e fëmijëve në situatë vulnerabël. Nuk janë të pranishme organizata joqeveritare aktive që të ofrojnë shërbime shtesë apo të plotësojnë boshllëqet institucionale në territor.

I vetmi mekanizëm funksional në territor është Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF), i cili, në zbatim të kuadrit ligjor, ngre dhe thërret rregullisht grupet teknike të rasteve sa herë që vlerësohet e nevojshme. PMF-ja ka një rol kyç në identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe bashkëpunon ngushtësisht me psikologët e shkollave dhe institucionet e tjera publike për të siguruar ndërhyrje të koordinuar. Megjithatë, ky funksion përballet me ngarkesë të lartë pune dhe mungesë mbështetjeje nga Njësia e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN), e cila nuk është funksionale në Bashkinë Delvinë.

Në vitin 2025, në Bashkinë Delvinë është ngritur Qendra Multifunksionale për Shërbimet Sociale, e cila ofron kurse digjitale për të rinjtë, me fokus të veçantë tek ata në situatë vulnerabël. Megjithëse kjo qendër nuk është në varësi të strukturës së shërbimeve sociale të bashkisë, ajo përfaqëson një mundësi konkrete për fuqizimin e të rinjve përmes aftësimi profesional dhe trajnimeve moderne në teknologji.

Mungon një qasje e integruar për mbështetjen e fëmijëve në rrezik, veçanërisht për ata me aftësi të kufizuara, fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe ata që jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe sociale. Kjo situatë nënvizon nevojën për ndërtimin e një rrjeti shërbimesh bazuar në bashkëpunim ndërsektorial dhe përfshirjen aktive të komunitetit.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Bazuar në analizën e situatës, boshllëqet ekzistuese dhe kapacitetet e kufizuara, identifikohen këto nevoja prioritare për ndërhyrje në mbështetje të fëmijëve në Bashkinë Delvinë:

1. Zhvillimi i shërbimeve komunitare dhe ditore për fëmijët – Krijimi i hapësirave mbështetëse për fëmijët në situatë rreziku, përfshirë shërbime rehabilituese, edukim joformal dhe mbështetje psikologjike.
2. Ngritja dhe forcimi i strukturave institucionale vendore – Krijimi i Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN) dhe rritja e kapaciteteve të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF), përmes mbështetjes me burime dhe staf ndihmës.
3. Parandalimi i braktisjes shkollore dhe rritja e përfshirjes në arsim – Vendosja e mekanizmave për identifikimin dhe ri-integrimin e fëmijëve që braktisin shkollën, me ndërhyrje të koordinuara dhe mbështetje për familjet.
4. Zgjerimi i qasjes në shërbime psikologjike dhe sociale – Ofrimi i mbështetjes profesionale për fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës, neglizhencës dhe traumave të tjera sociale.
5. Rritja e bashkëpunimit ndërsektorial dhe përfshirja e komunitetit – Angazhimi i OJF-ve dhe aktorëve lokalë për të ndërtuar një rrjet shërbimesh të koordinuara dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët në nevojë.

Situata e fëmijëve në Bashkinë Delvinë evidencon sfida serioze në drejtim të përfshirjes sociale, mbrojtjes nga rreziqet dhe aksesit të kufizuar në shërbime cilësore. Megjithëse ekziston një angazhim institucional përmes rolit të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës, mungesa e strukturave mbështetëse, si NJVRN, shërbimet ditore dhe mbështetja shumëdisiplinore, e kufizojnë ndjeshëm reagimin efektiv ndaj nevojave të fëmijëve në rrezik. Kjo diagnozë thekson domosdoshmërinë për një ndërhyrje të koordinuar, me përfshirje të aktorëve vendorë dhe organizatave të shoqërisë civile, për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të mbrojtjes së fëmijës në nivel lokal.

1.4 Diagnoza për viktimat e dhunës dhe trafikimit

Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje përbëjnë një sfidë të rëndësishme për shoqërinë dhe kërkojnë vëmendje të koordinuar në nivel lokal. Diagnoza për dhunën në Bashkinë Delvinë synon të eidentojë përmasat e këtij fenomeni, boshllëqet në reagimin institucional dhe nevojat prioritare për ndërhyrje, duke u mbështetur në të dhëna zyrtare dhe në informacionin e mbledhur përmes takimeve me komunitetin dhe aktorët vendorë.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Në Bashkinë Delvinë, numri i rasteve të dhunës së raportuar është relativisht i ulët, megjithatë dhuna në familje dhe format e tjera të dhunës mbeten një nga problematikat më të ndjeshme sociale në territor. Ndër viktimat përfshihen gra, fëmijë dhe raste të dhunës me bazë gjinore, por të dhënat ekzistuese janë të kufizuara dhe të fragmentuara. Sfida kryesore lidhet me mosdenoncimin e dhunës nga viktimat, i ndikuar nga mungesa e besimit tek institucionet, frika nga stigmatizimi në komunitet, mentaliteti patriarkal dhe varësia ekonomike e grave. Në komunitetet e vogla, ruajtja e konfidencialitetit mbetet e vështirë, çka e bën edhe më delikate situatën e viktimave. Një sfidë tjetër lidhet me mbivendosjen e funksioneve në një person të vetëm (koordinatori për dhunën, i cili ushtron njëkohësisht edhe rolin e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës), çka mund të kufizojë kapacitetin për ndjekje të dedikuar dhe të qëndrueshme të rasteve. Në këtë kontekst, përmirësimi i mekanizmave të referimit dhe krijimi i shërbimeve të specializuara janë hapa të domosdoshëm për të garantuar mbrojtje efektive, të aksesueshme dhe të qëndrueshme për viktimat e dhunës.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Të dhënat për vitet 2022–2024 tregojnë një numër të ulët zyrtar të rasteve të dhunës: gjithsej 4 raste të Urdhrave të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMM) në vitin 2024 (nga 7 në 2023), dhe 2 raste të Urdhrave të Mbrojtjes (UM) në 2024 (nga 3 në 2023 dhe 11 raste në vitin 2022). Kjo ulje nuk përfaqëson një përmirësim të situatës, por lidhet me faktorë pengues në denoncim dhe raportim të rasteve nga viktimat. Nga konsultimet me komunitetin dhe aktorët institucionalë rezultoi se rastet reale janë më të shumta se ato të pasqyruara në sistemet zyrtare.

Ekzistojnë mospërputhje ndërmjet të dhënave të Policisë, Koordinatorit për Dhunën dhe Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës (PMF), të cilët në rastin e Bashkisë Delvinë janë i njëjti person. Kjo situatë e bën të vështirë ndarjen e qartë të përgjegjësive dhe mund të ndikojë në konsistencën e raportimit, sidomos për rastet që përfshijnë fëmijë. Për shembull, Policia raporton 2 raste që përfshijnë fëmijë, PMF 3 raste, ndërsa Koordinatori për Dhunën nuk raporton asnjë – pavarësisht se funksionet kryhen nga e njëjta figurë institucionale.

Boshllëqet kryesore të evidentuara lidhen me:

- Faktorë pengues për denoncimin e dhunës nga viktimat, si frika nga stigmatizimi, mungesa e besimit tek institucionet dhe pasiguria për mbështetje reale;
- Mospërputhje dhe fragmentim të të dhënave ndërmjet institucioneve, që e vështirësojnë ndërtimin e një panorame të qartë mbi përmasat reale të fenomenit;
- Mungesën e shërbimesh sociale të specializuara në nivel vendor, përfshirë mbështetje psikologjike, ligjore dhe strehim emergjent për viktimat e dhunës.
- Mungesën e Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN), që do të siguronte koordinim ndër-institucional dhe menaxhim më të integruar të rasteve

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Aktualisht, Bashkia Delvinë nuk ofron një sistem të strukturuar shërbimesh për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës. Funksioni i vetëm i organizuar është ai i koordinatorit për dhunën dhe barazinë gjinore, i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me

kuadrin ligjor dhe në bashkëpunim me institucionet shtetërore, si Komisariati i Policisë, strukturat e shëndetësisë dhe të tjerë aktorë institucionalë. Ndër funksionet e tij përfshihet edhe thirrja dhe drejtimi i grupeve teknike për menaxhimin e rasteve të identifikuar.

Në rastet që kërkojnë zgjidhje më të ndërlikuara ose mbështetje të specializuar, koordinatori bashkëpunon me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në Vlorë dhe me organizatën “Vatra”, e cila mbulon ofrimin e shërbimeve emergjente dhe të rehabilitimit për viktimat e dhunës në nivel rajonal. Bashkëpunimi zgjerohet edhe me organizata të tjera që operojnë në bashkitë përreth, si në Sarandë, sipas nevojës së rasteve.

Në nivel vendor, nuk ekziston një strukturë institucionale e dedikuar specifikisht për menaxhimin e rasteve të dhunës, si p.sh. një qendër për mbështetjen e viktimave apo një shërbim i integruar psiko-social. Megjithatë, administratorët shoqërorë në njësitë administrative ofrojnë shërbime të natyrës parashoqërore dhe, në mungesë të Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN), luajnë njëkohësisht edhe rolin bazë të identifikimit, vlerësimit fillestar dhe referimit të rasteve në territor.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Në vijim identifikohen nevojat prioritare për ndërhyrje, të cilat burojnë nga boshllëqet e evidentuara dhe situata aktuale në menaxhimin e rasteve të dhunës në nivel vendor:

- ✓ Krijimi i një shërbimi të strukturuar për viktimat e dhunës.
- ✓ Ngritja e një sistemi të unifikuar për raportimin dhe ndarjen e të dhënave për të shmangur mospërputhjet dhe për të garantuar mbrojtje efektive për viktimat.
- ✓ Fuqizimi i mekanizmit të integruar të referimit dhe menaxhimit të rasteve të dhunës, përfshirja e strukturave lokale në një qasje të koordinuar shumëdisiplinore.
- ✓ Mbështetje për koordinuesin e dhunës përmes shtimit të stafit ndihmës dhe ndarjes së roleve për të reduktuar ngarkesën institucionale.
- ✓ Fuqizimi i rolit të bashkisë në parandalimin e dhunës përmes fushatave ndërgjegjësuëse, edukimit komunitar dhe përfshirjes së të rinjve, shkollave dhe organizatave lokale.

Diagnoza eidenton qartë se përballja me fenomenin e dhunës në Bashkinë Delvinë kërkon ndërhyrje të strukturuar në dy nivele: forcimin e rolit të institucioneve vendore në mbështetje të viktimave dhe fuqizimin e mekanizmave funksionalë të bashkëpunimit ndërinstitutional. Ndërsa ekziston një bazë fillestare reagimi përmes rolit të koordinatorit të dhunës dhe administratorëve shoqërorë, mungesa e shërbimeve shoqërore, si strehimi emergjent, këshillimi psiko-social apo një qendër mbështetëse në territor, tregon për nevojën urgjente të investimit në këtë drejtim. Krijimi i një sistemi të integruar dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e rasteve është parakusht për të garantuar mbrojtje dinjitoze, gjithëpërfshirëse dhe efektive.

1.5 Diagnoza për të Moshuarit në Nevojë – Bashkia DELVINË

Plakja e popullsisë është një realitet që po prek gjithnjë e më shumë komunitetet lokale, përfshirë Bashkinë Delvinë. Kjo situatë kërkon jo vetëm evidentimin e numrit të të moshuarve, por edhe një kuptim më të thelluar të nevojave dhe kushteve në të cilat ata

jetojnë. Diagnoza e mëposhtme synon të analizojë kapacitetet ekzistuese dhe boshllëqet në ofrimin e shërbimeve për moshën e tretë, me qëllim orientimin e politikave sociale drejt një mbështetjeje më efektive, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Sipas Censurit 2023, në Bashkinë Delvinë jetojnë gjithsej 1,649 të moshuar, që përbëjnë rreth 26.7% të popullsisë totale. Kjo përqindje e lartë reflekton një proces të dukshëm plakjeje të popullsisë dhe rrit nevojën për ndërhyrje të posaçme sociale. Të moshuarit në territor përballen me sfida të shumta, përfshirë vetminë, mungesën e kujdesit të përditshëm, varësinë nga të tjerët për shërbime bazë, si dhe izolimin social. Sfidë përbën mungesa e shërbimeve shoqërore për këtë grupmoshë dhe mungesa e një figure të dedikuar institucionale për ndjekjen e problematikave të tyre.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Të dhënat për vitin 2024 tregojnë se 49 të moshuar kanë kërkuar mbështetje për shërbime sociale, 17 të moshuar kërkojnë shërbim në familje, 24 kërkojnë shërbim në qendër ditore dhe vetëm 1 kërkon shërbim rezidencial. Ndërkohë, 58 të moshuar klasifikohen si “në nevojë”, nga të cilët 44 të vetmuar, 5 të sëmurë, 1 i braktisur dhe 8 të moshuar që jetojnë vetëm dhe përfitojnë ndihmë ekonomike. Mungojnë të dhëna të detajuara për njësinë administrative Vergo, çka pengon planifikimin e shërbimeve në mënyrë të decentralizuar dhe të orientuar drejt nevojës specifike.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Në Bashkinë Delvinë funksionon një qendër ditore për të moshuarit në nevojë, e mbështetur nga Fondi Social I MSHMS dhe Bashkia. Ajo ofron ushqim dhe aktivitete sociale për 25 përfitues, nga të cilët 20% janë gra. Ky është shërbimi i vetëm i strukturuar për këtë kategori. Në mungesë të një pozicioni të dedikuar për të ndjekur problematikat e moshës së tretë, shërbimet në komunitet ofrohen nga administratorët shoqërorë, të cilët mbulojnë shërbimet parashoqërore dhe luajnë njëkohësisht edhe rolin bazë të identifikimit dhe referimit të rasteve në mungesë të NJVRN. Mungojnë organizatat e shoqërisë civile në territor, të cilat mund të ofronin mbështetje dhe alternativa të tjera të kujdesit shoqëror për të moshuar në nevojë.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Në këtë kontekst, evidentohen nevojat më urgjente për ndërhyrje, të cilat synojnë të përmirësojnë cilësinë e jetës së të moshuarve dhe të rrisin përfshirjen e tyre në shërbimet sociale

- ✓ Zgjerimi i shërbimit ekzistues ditor për të moshuarit, për të përfshirë më shumë përfitues duke u zgjeruar edhe në njesinë administrative Vergo;
- ✓ Ofrimi i shërbimeve në familje për të moshuarit e vetmuar dhe të sëmurë, përmes një shërbimi të strukturuar të ndihmës në shtëpi;
- ✓ Vlerësimi i mundësisë për ngritjen e një shërbimi rezidencial rajonal, në bashkëpunim me bashkitë fqinje dhe Keshillin e Qarkut Vlorë;

- ✓ Krijimi i një pozicioni të dedikuar për çështjet e të moshuarve në strukturën e shërbimeve sociale;
- ✓ Ndërtimi i një sistemi të plotë të të dhënave për të moshuarit sipas njësive administrative dhe sipas llojit të nevojës;
- ✓ Aktivizimi i rrjeteve komunitare dhe bashkëpunimi me OJF për të reduktuar izolimin social dhe për të rritur përfshirjen e të moshuarve në jetën e komunitetit.

Diagnoza për moshën e tretë në Bashkinë Delvinë nënvizon domosdoshmërinë e një qasjeje më të strukturuar dhe të drejtuar drejt territorit për të përballuar sfidat që lidhen me plakjen e popullsisë. Ndërhyrjet aktuale janë të kufizuara dhe nuk arrijnë të mbulojnë në mënyrë të plotë nevojat e të moshuarve, veçanërisht për ata që jetojnë vetëm, janë në kushte të vështira shëndetësore ose nuk kanë mbështetje familjare. Ngritja e një rrjeti shërbimesh sociale të përshtatura për këtë grup, përfshirja e komunitetit dhe forcimi i rolit të strukturave vendore janë hapat kyç për të garantuar një pleqëri me dinjitet dhe mbështetje reale për çdo të moshuar në territor.

1.6 Diagnoza për individë përdorues të alkoolit

Edhe për përdoruesit e alkoolit, të dhënat janë të fragmentuara dhe mbështeten vetëm në informacionin e Policisë së Shtetit, e cila raporton 6 raste (të gjithë burra dhe djem). Nuk ekzistojnë të dhëna të detajuara për çdo njësi administrative dhe mungon një sistem i mirëfunksionuar për identifikimin, vlerësimin dhe referimin e rasteve. Kjo situatë pengon ndërhyrjen e koordinuar për ofrimin e mbështetjes psiko-sociale dhe shërbimeve rehabilituese. Krijimi i NJVRN do të ndihmonte në evidentimin dhe menaxhimin më të plotë të kësaj kategorie në nivel vendor.

1.7 Diagnoza për individë përdorues të drogës

Në Bashkinë Delvinë mungojnë të dhëna të strukturuar për përdoruesit e drogave, si nga bashkia ashtu edhe nga shërbimi shëndetësor. I vetmi institucion që raporton raste është Policia, e cila referon 4 përdorues droge (të gjithë burra dhe djem), me të dhëna të kufizuara vetëm në nivel bashkie dhe jo sipas njësive administrative. Mungesa e një mekanizmi ndërinstitutional e pengon identifikimin dhe mbështetjen e kësaj kategorie. Ngritja e Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN) do të përmirësonte ndjeshëm evidentimin, koordinimin dhe trajtimin e rasteve përmes një qasjeje të integruar

1.8 Diagnoza për individë LGBTIQ+

Në Bashkinë Delvinë nuk ka asnjë informacion të disponueshëm nga strukturat vendore, institucionet shëndetësore apo të rendit për personat LGBTIQ+. Kjo kategori është e padukshme në statistikat vendore, pjesërisht për shkak të numrit të vogël të popullsisë, por mbi të gjitha për shkak të mungesës së një mjedisi të sigurt për vetëdeklarim. Frika nga stigmatizimi dhe diskriminimi ndikon në heshtjen e kësaj kategorie. Ngritja e NJVRN do të mundësonte jo vetëm identifikimin dhe referimin konfidencial të rasteve, por edhe

ndërtimin e një qasjeje më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë ndaj të drejtave të këtij komuniteti në nivel vendor.

Përmbledhje e diagnozës sociale së familjeve dhe individëve në nevojë

Në Bashkinë Delvinë, diagnozat për kategoritë në nevojë evidentojnë një sërë sfidash të ndërlydhura me plakjen e popullsisë, varfërinë, mungesën e shërbimeve të strukturuar dhe mungesën e mekanizmave për përfshirjen sociale të grupeve më vulnerabël. Të moshuarit përbëjnë një përqindje të lartë të popullsisë (26.7%), shumë prej tyre të vetmuar, pa mbështetje familjare dhe të ekspozuar ndaj izolimit social. Fëmijët, megjithëse përfaqësojnë një përqindje të ulët të popullsisë (11.4%), përballen me rrezikun e dhunës, përjashtimit social dhe braktisjes shkollore, ndërsa mungojnë shërbime komunitare dhe mbështetëse për ta. Familjet në nevojë përbëjnë një tjetër kategori e pambrojtur, ku përfituesit e ndihmës ekonomike janë të shumtë, por shpesh nuk mbulojnë me shërbime sociale përtej asistencës financiare. Personat me aftësi të kufizuara dhe viktimat e dhunës, përballen me mungesën e mbështetjes së specializuar dhe infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve rehabilituese, edukative dhe të mbrojtjes. Ndërkohë, të rinjtë dhe përdoruesit e substancave mbeten të papërfshirë në politikat sociale aktuale. Në mungesë të strukturave të qëndrueshme, shërbimet mbështetëse ofrohen nga administratorët shoqërorë dhe një numër i kufizuara specialistësh që mbulojnë njëkohësisht disa role. Diagnozatat theksojnë nevojën për forcimin e strukturave institucionale, zgjerimin e shërbimeve, përmirësimin e bashkëpunimit ndërsektorial dhe ngritjen e mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e nevojave të grupeve vulnerabël.

2. Diagnoza e shërbimeve shoqërore

Shërbimet sociale përbëjnë një komponent thelbësor të mbrojtjes sociale dhe mirëqenies së grupeve vulnerabël në nivel vendor. Diagnoza e situatës në Bashkinë Delvinë synon të evidentojë kapacitetet ekzistuese, boshllëqet në mbulim, sfidat në ofrim dhe mundësitë për ndërhyrje të strukturuar për të garantuar një sistem më gjithëpërfshirës dhe funksional të mbështetjes sociale.

1. Përshkrimi i përgjithshëm dhe sfidat kryesore

Shërbimet sociale në Bashkinë Delvinë përballen me sfida të mëdha për shkak të mospërputhjes ndërmjet kërkesës për mbështetje dhe kapaciteteve të kufizuara për ofrim shërbimesh. Kategoritë që kanë nevojë për mbështetje përfshijnë fëmijët në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit e vetmuar, familjet përfituese të ndihmës ekonomike, viktimat e dhunës, si dhe individë me vështirësi psiko-sociale, përfshirë përdorues të substancave dhe persona LGBTQ+. Sfidat kryesore lidhen me mungesën e shërbimeve të strukturuar për pjesën më të madhe të këtyre grupeve, mungesën e Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN), ngarkesën e lartë të stafit ekzistues dhe alternativat e kufizuara vendore për strehim, rehabilitim dhe ndërhyrje sociale.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Të dhënat e mbledhura nga bashkia tregojnë për një numër të lartë individësh në nevojë: 111 fëmijë në nevojë, 487 persona me aftësi të kufizuara, 58 të moshuar në nevojë (prej të cilëve 27 marrin shërbim), 156 familje në ndihmë ekonomike, 2 viktime të dhunës, si dhe raste të kufizuara të përdoruesve të substancave narkotike (4) dhe alkoolit (6). Për personat LGBTIQ+ nuk disponohen të dhëna. Vetëm për një kategori (të moshuarit) ekziston një shërbim i drejtpërdrejtë funksional, ndërsa për pjesën tjetër mbështetja kufizohet në ndihmë parashoqërore nga administratorët. Mungojnë të dhëna të detajuara sipas njësive administrative dhe një sistem i konsoliduar për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi territorial

Bashkia Delvinë ofron aktualisht një shërbim të vetëm të strukturuar: qendra ditore për të moshuarit në nevojë, e mbështetur nga fondi social, ku marrin shërbime të përditshme 27 individë (ushqim, aktivitete sociale, mbështetje psikologjike). Nuk ekzistojnë shërbime të ngjashme në zonat rurale, duke lënë një pjesë të konsiderueshme të të moshuarve pa mbështetje të strukturuar shoqërore. Qendra Multifunkionale për Shërbimet Sociale, e ngritur në vitin 2025 pranë bashkisë, por jo e strukturuar brenda sektorit social, ofron aktualisht kurse aftësimi dhe formimi dixhital për të rinjtë, duke kontribuar në mënyrë të përdorshme në fuqizimin e tyre social dhe ekonomik

Bashkia Delvinë ofron, evidenton, menaxhon dhe ndjek rastet e fëmijëve në rrezik dhe të viktimave të dhunës, duke ngritur strukturat përkatëse konform legjislacionit në fuqi, si Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) dhe Koordinatori për Dhunën dhe Barazinë Gjinore. Aktualisht, të dyja funksionet ushtrohen nga i njëjti person, çka përbën një mbivendosje funksionesh, Bashkia Delvinë duhet të ketë minimalisht një PMF dhe një Koordinator për Dhunën dhe Barazinë Gjinore me role të ndara dhe të specializuara, për të garantuar mbulim të plotë dhe ndërhyrje cilësore.

Për kategoritë e tjera, përfshirë familjet në nevojë. PAK, etj mbështetja ofrohet vetëm nga administratori shoqëror. Administratorët luajnë një rol kyç edhe si hallkë zëvendësuese e NJVRN dhe janë pjesë e grupeve teknike për menaxhimin e rasteve. Bashkia bashkëpunon rastësisht me OJF si “Vatra” apo organizata që veprojnë në bashki fqinje, por nuk ka OJF aktive në territorin e saj që ofrojnë shërbime të mirëfillta shoqërore. Prania e Motrave Françeskane, megjithëse e kufizuar në shërbime humanitare të përgjithshme, përfaqëson një burim të vlefshëm mbështetjeje morale dhe ndihme bazike për familjet më në nevojë

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Bazuar në të dhënat e mësipërme, në vijim paraqiten nevojat kryesore për ndërhyrje prioritare që synojnë forcimin e rrjetit vendor të shërbimeve sociale:

- ✓ Ngritja e Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN) në përputhje me kërkesat ligjore, për të mundësuar menaxhimin ndërsektorial të rasteve në nivel vendor;
- ✓ Zhvillimi i shërbimeve të strukturuar për fëmijët në nevojë, PAK, viktimat e dhunës dhe familjet në vështirësi, në bashkëpunim me Qendrën Multifunkionale për Shërbimet Sociale në qytetin e Delvinës;

- ✓ Zgjerimi i shërbimit ekzistues për të moshuarit dhe hapja e formave të kujdesit në familje për individët e vetmuar ose të sëmurë;
- ✓ Rritja e kapaciteteve të administratorëve shoqërorë dhe ndarja funksionale e roleve për PMF, NJVRN dhe Koordinatorin për Dhunën;
- ✓ Ndërtimi i partneriteteve me OJF dhe shërbime rajonale për strehim emergjent dhe trajtim të rasteve komplekse (si dhuna, varësia, apo komunitetet e padukshme);
- ✓ Krijimi i një sistemi të integruar të të dhënave për monitorimin e kategorive në nevojë dhe ndjekjen e trajtimit të tyre në kohë reale.

Shërbimet sociale në Bashkinë Delvinë karakterizohen nga një përpjekje e kufizuar institucionale për të garantuar mbështetje të strukturuar për grupet në nevojë. Përveç qendrës ditore për të moshuarit, shërbimet për kategori të tjera – si fëmijët në rrezik, PAK, viktimat e dhunës dhe familjet në vështirësi – mbështeten në angazhimin e stafit minimal dhe rolit të administratorëve shoqërorë, të cilët kryejnë funksione të shumta përfshirë edhe atë të NJVRN. Mungesa e strukturave të posaçme si NJVRN dhe ndarja e qartë funksionale për rolet e PMF dhe Koordinatorit të Dhunës, dobëson përgjigjen ndërinstucionale dhe zgjidhjen e rasteve komplekse. Prania sporadike e OJF-ve dhe mungesa e një rrjeti të integruar referimi theksojnë nevojën për ndërhyrje të menjëhershme për ndërtimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe funksional të mbrojtjes sociale në nivel vendor. Për shkak të buxhetit të kufizuar dhe të ardhurave vetjake të papërfillshme, Bashkia Delvinë varet kryesisht nga fondet qeveritare për të financuar shërbimet sociale, çka përbën një sfidë të vazhdueshme për zgjerimin dhe qëndrueshmërinë e tyre.

3. Diagnoza për Burimet Njerëzore në Shërbimet Sociale në Bashkinë DELVINË

Diagnoza e burimeve njerëzore në fushën e shërbimeve sociale në Bashkinë Delvinë synon të analizojë kapacitetet ekzistuese, sfidat strukturore dhe nevojën për ndërhyrje në funksion të përmirësimit të përgjigjes institucionale ndaj grupeve në nevojë.

1. Përshkrimi i përgjithshëm dhe sfidat kryesore

Struktura aktuale e burimeve njerëzore të përfshira në ofrimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Delvinë është pjesë e varësisë së Drejtorisë së Financës, e cila mbulon njëkohësisht edhe fushat e strehimit dhe arsimit. Struktura përfshin një përgjegjës, një punonjës për personat me aftësi të kufizuara (PAK), një specialist për ndihmën ekonomike dhe ndihmen, një punonjës për mbrojtjen e fëmijës (NJMF) njëkohësisht koordinator për dhunën dhe një specialist për arsimin. Ngarkesa shumësektoriale dhe mungesa e ndarjes së qartë funksionale për çdo kategori në nevojë, përbëjnë një nga sfidat kryesore në sigurimin e një përgjigjeje të specializuar dhe të efektshme.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Aktualisht, një numër i kufizuar punonjësish mbulon një gamë të gjerë përgjegjësish, duke përfshirë mbrojtjen e fëmijëve, trajtimin e rasteve të dhunës, ndihmën ekonomike, PAK,

arsimin dhe aspektet e strehimit. Në disa raste, një person i vetëm mbulon dy funksione kyçe (si p.sh. NJMF dhe koordinatori i dhunës), duke ndikuar negativisht në kapacitetin për të ndjekur dhe trajtuar rastet në mënyrë profesionale. Mungon gjithashtu një njësi e specializuar për menaxhimin e rasteve komplekse dhe një sistem për trajnimin e vazhdueshëm të stafit për qasje ndërdisiplinore.

3. Mungesa dhe ndarja funksionale

Bashkia nuk ka ende të ngritur Njësinë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN), një mekanizëm kyç për menaxhimin e rasteve të ndërlikuara dhe referimin ndërinstytucional. Administratorët shoqërorë të njësive administrative përpiqen të luajnë një rol zëvendësues në këtë drejtim, por pa një formim të posaçëm dhe pa koordinim të duhur, ndikimi mbetet i kufizuar. Gjithashtu, mungon një strukturë e dedikuar për të moshuarit dhe për përdoruesit e substancave, ndërkohë që prania e një specialisti për shërbimet psiko-sociale është e domosdoshme.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Nevojat për ndërhyrje prioritare përfshijnë:

- ✓ Rritja e numrit të punonjësve socialë dhe ndarja e qartë e roleve sipas kategorive në nevojë.
- ✓ Ngritja e Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN) në përputhje me kuadrin ligjor.
- ✓ Krijimi i një strukture të dedikuar për të moshuarit, PAK dhe për viktimat e dhunës.
- ✓ Trajnimi i vazhdueshëm i stafit për qasje ndërdisiplinore dhe menaxhimin e rasteve komplekse.
- ✓ Mbështetje për strukturat vendore me burime të qëndrueshme financiare dhe teknike.

Forcimi i kapaciteteve njerëzore në nivel vendor mbetet një parakusht për funksionimin e qëndrueshëm të sistemit të mbrojtjes sociale në Bashkinë Delvinë. Vetëm përmes një strukture të ndarë mirë, të trajnuar dhe të integruar në mekanizmat shumëdisiplinorë, mund të garantohet ofrimi i shërbimeve të orientuara drejt qytetarëve në nevojë.

4. Përmbyllje e diagnozës së Planit Social Vendor në Bashkinë DELVINË

Diagnoza përmbledhëse për Bashkinë Delvinë evidenton një kontekst sfidues në mbrojtjen sociale, karakterizuar nga kërkesa të larta për shërbime dhe kapacitete të kufizuara për përmbushjen e tyre. Të dhënat tregojnë se grupet më të prekura përfshijnë fëmijët në rrezik, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit e vetmuar, viktimat e dhunës, familjet me ndihmë ekonomike dhe individët me vështirësi psiko-sociale. Shërbimet ekzistuese mbulohen kryesisht nga qendra ditore për të moshuarit dhe ndihma e administratorëve socialë, duke përfshirë edhe funksionet e mbivendosura të Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës dhe Koordinatorit të Dhunës. Mungesa e Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN), shërbimeve të strukturuar për grupet vulnerabël dhe alternativave rehabilituese mbetet pengesë kritike. Në aspektin e burimeve njerëzore, Bashkia ka një numër të kufizuar stafi dhe mungesë strukturimi të dedikuar për mbrojtjen sociale.

Pavarësisht këtyre boshllëqeve, Bashkia ka projektuar përmes Planit Social 2025–2028 masa të qarta dhe të realizueshme: zgjerimin e shërbimeve ekzistuese, ngritjen e strukturave të reja, përfshirë një NJVRN funksionale, fuqizimin e rolit të PMF dhe Koordinatorit për Dhunën, ofrimin e kurseve digjitale për të rinjtë përmes Qendrës Multifunktionale si dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Këto masa shënjojnë një angazhim konkret për ndërtimin e një sistemi të integruar dhe gjithëpërfshirës të mbrojtjes sociale, në përputhje me nevojat reale të komunitetit.

5. Analiza SWOT

Analiza SWOT – Mundësia për Zbatimin e Planit Social 2025–2028 – Bashkia DELVINË

Pikat e Forta (Strengths):

- Plani Social është ndërtuar mbi një diagnozë të detajuar, të mbështetur në të dhëna konkrete dhe analiza sektoriale.
- Egziston një strukturë funksionale për ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale në nivel vendor.
- Bashkia ofron aktualisht një qendër ditore për të moshuarit në nevojë, funksionale dhe e mbështetur me fondin social.
- Administratoret shoqërorë mbulojnë të gjithë territorin e bashkisë dhe luajnë rol kyç në identifikimin dhe ndjekjen e rasteve.
- Është krijuar një sistem i integruar bazik për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe viktimave të dhunës, përmes funksioneve të PMF dhe koordinatorit për barazi gjinore (edhe pse të mbivendosura aktualisht).
- Ekzistenca e Qendrës Multifunktionale për Shërbimet Sociale, e cila ofron kurse digjitale për të rinjtë dhe programe zhvillimi, përbën një aset të rëndësishëm për forcimin e ndërhyrjeve sociale.

Dobësitë (Weaknesses):

- Burimet njerëzore janë të kufizuara në numër dhe kapacitete, me mbivendosje funksionesh (PMF – Koordinator i Dhunës).
- Mungon pozicioni i përgjegjës të Sektorit
- Mungesa e Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN).
- Funksionimi i Qendrës Multifunktionale jashtë strukture se sektorit social kufizon koordinimin dhe efikasitetin e shërbimeve.
- Mungesa e shërbimeve të strukturuar për kategoritë në nevojë, sidomos për PAK, viktimat dhune, LGBTIQ+, përdorues të substancave dhe fëmijë në rrezik.
- Të ardhurat e veta të bashkisë janë minimale dhe nuk mbulojnë nevojat për bashkëfinancim ose zgjerim shërbimesh.

Mundësitë (Opportunities):

- Kuadri ligjor kombëtar për mbrojtjen sociale dhe decentralizimin e shërbimeve i hap rrugë bashkive për të strukturuar dhe zgjeruar shërbimet sociale.
- Mundësia për të përfituar fonde nga skemat e mbështetjes qeveritare (fondi social, fondet e AKPAK, fondi për viktimat e dhunës etj.).
- Programe dhe thirrje të hapura nga donatorë ndërkombëtarë për forcimin e shërbimeve sociale dhe ndërtimin e kapaciteteve vendore.
- Nxitja e bashkëpunimit ndërbashkiak ose rajonal për krijimin e shërbimeve të përbashkëta (për shembull: strehim, rehabilitim, etj.).
- Prezenca e aktorëve fetarë ose humanitarë (si motrat françeskane) që mund të forcojnë ndërhyrjet sociale në komunitet.

Kërcënimet (Threats):

- Vonesat apo mungesa e mbështetjes financiare nga qeveria qendrore për realizimin e objektivave të planit.
- Rreziku që projektet e nisura të mos jenë të qëndrueshme në mungesë të burimeve të sigurta afatgjata.
- Mungesë e organizatave joqeveritare aktive në territor që të ofrojnë shërbime alternative ose partnere për bashkëpunim.
- Emigrimi dhe plakja e popullsisë ul kërkesën për disa shërbime, por rrit nevojën për të tjerë, duke e bërë planifikimin më kompleks.
- Vështirësia për të siguruar staf të kualifikuar për ofrimin e shërbimeve sociale në zonat e thella rurale.

IV. Vizioni, Misioni , Prioritetet Strategjike dhe Objektivat

Plani Social Vendor i Bashkisë Delvinë 2025–2028 ndërtohet në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe prioritetet e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel vendor. Ky plan synon të orientojë ndërhyrjet për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe fuqizimin e mbrojtjes për kategoritë në nevojë, duke u mbështetur në një qasje gjithëpërfshirëse, të integruar dhe të bazuar në evidenca. Përmes një vizioni të qartë, një misioni të përkushtuar dhe prioritetëve strategjike të fokusuar, Bashkia Delvinë angazhohet të ndërtojë një sistem social funksional, të qëndrueshëm dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e saj.

Vizioni

Të ndërtojmë një bashki gjithëpërfshirëse, me një sistem të qëndrueshëm dhe efektiv të mbrojtjes sociale, që garanton dinjitet, barazi dhe mirëqenie për çdo qytetar, veçanërisht për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe familjet e rrezikuara nga margjinalizimi.

Vizioni

Të ndërtojmë një bashki gjithëpërfshirëse, me një sistem të qëndrueshëm dhe efektiv të mbrojtjes sociale, që garanton dinjitet, barazi dhe mirëqenie për çdo qytetar, veçanërisht

për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe familjet e rrezikuara nga marginalizimi.

Misioni

Të zhvillojmë dhe zbatojmë politika vendore gjithëpërfshirëse të mbrojtjes sociale, të bazuara në parimin e barazisë dhe aksesit të barabartë në shërbime, përmes rritjes së kapaciteteve lokale, forcimit të partneriteteve dhe sigurimit të një reagimi të integruar dhe të orientuar drejt individit.

Drejtimit Prioritare të Planit Social Vendor

1. Zgjerimi i shërbimeve sociale për grupet në nevojë.
2. Rritja e aksesit dhe pjesëmarrjes përmes sistemit të referimit.
3. Fuqizimi i burimeve njerëzore dhe logjistike.
4. Bashkëpunimi me aktorë lokalë dhe rajonalë.
5. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për çështjet sociale.
6. Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave për planifikim dhe monitorim.

Në funksion të këtij vizioni dhe në përputhje me misionin dhe qëllimin e planit, janë përcaktuar katër prioritete strategjike që përmbledhin drejtimit kryesore të ndërhyrjes në fushën e mbrojtjes sociale në Bashkinë DELVINË Bazuar në analizën e situatës sociale dhe procesin gjithëpërfshirës të hartimit, prioritetet strategjike të Planit Social Vendor janë ndërtuar në mënyrë të harmonizuar, pa mbivendosje dhe me qëllim për të mbuluar në mënyrë gjithëpërfshirëse nevojat e grupeve vulnerabël në territorin e Bashkisë Delvinë. Çdo prioritet është i fokusuar në një drejtim të veçantë – ofrimi dhe zgjerimi i shërbimeve sociale, edukimi dhe ndërgjegjësimi komunitar, forcimi i kapaciteteve institucionale, si dhe ngritja e mekanizmave për monitorim dhe të dhëna – duke krijuar një strukturë që garanton koherencë të brendshme dhe funksionalitet praktik. Ndërthurja logjike midis prioriteteve krijon sinergji pozitive në zbatim dhe ndihmon në ndërtimin e një sistemi social vendor më të qëndrueshëm, të orientuar nga evidencat dhe i ndjeshëm ndaj kontekstit lokal. Kjo qasje përforcon kapacitetin e bashkisë për planifikim afatgjatë, vendimmarrje të informuar dhe ofrim të shërbimeve cilësore për të gjithë qytetarët në nevojë.

PRIORITETI 1 – Zhvillimi dhe diversifikimi i shërbimeve sociale për grupet më të cenueshme, me fokus tek të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në konflikt me ligjin.

Objektivi Specifik 1: Të sigurohet ofrimi i shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në konflikt me ligjin, në të gjithë territorin e Bashkisë Delvinë, përmes zgjerimit të formateve të shërbimit, përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese dhe ngritjes së kapaciteteve vendore.

Masa 1. Krijimi i shërbimeve të lëvizshme dhe në familje për të moshuarit dhe PAK.

Aktivitetet

- ✓ A 1.1 Hartimi i një plani për shërbimet e lëvizshme

- ✓ A 1.2 Trajnimi i stafit për ofrimin e shërbimeve në terren
- ✓ A 1.3 Pilotimi i shërbimeve në njësitë më të largëta të bashkisë.

Treguesit

- 5 punonjës të trajnuar
- 2 njësi administrative të mbuluara me shërbime
- 30 përfitues (PAK dhe të moshuar) përfitues të shërbimeve lëvizëse

Masa 2. Riorganizimi i qendrës ekzistuese për moshën e tretë në qendër multifunktionale.

Aktivitetet

- ✓ A 2.1 Hartimi i projektit teknik për ristrukturimin.
- ✓ A 2.2 Pajisja e qendrës me infrastrukturën për PAK.
- ✓ A 2.3 Zgjerimi i shërbimeve për përfitues të rinj (PAK, të rinj në nevojë).

Treguesit

- Projekti i riorganizimit përfunduar
- Qendra përdoret nga më shumë se 2 grupe ne nevoje (te moshuar dhe PAK)
- 10 përfitues të rinj në vit

Masa 3. Programe mbështetese për fëmijët në konflikt me ligjin dhe familjet e tyre

Aktivitete

- ✓ A 3.1 Hartimi i një shërbimi edukativ dhe rehabilitues
- ✓ A 3.2 Bashkëpunim me familjen, shkolla dhe qendra sociale
- ✓ A 3.3 Aktivitetet me fokus përfshirjen dhe mbështetjen e fëmijëve në nevojë

Treguesit:

- 17 fëmijë të përfshirë
- Raport vjetor i zbatimit

Masa 4. Zbatimi i programeve të aftësimin profesional për të rinjtë përmes kurseve dixhitale që ofrohen në Qendrën Multifunktionale për Shërbimet Sociale.

Aktivitete

- ✓ A 4.1 Identifikimi dhe përfshirja e të rinjve në programin e trajnimit, me fokus te ata në situatë vulnerabël.
- ✓ A 4.2 Zhvillimi i kurseve dixhitale në ambientet e Qendrës Multifunktionale, sipas programeve

Treguesit

- Numri i të rinjve të përfshirë në program gjatë vitit: ≥ 30
- Përqindja e të rinjve nga grupe vulnerabël: $\geq 50\%$
- Numri i kurseve të realizuara në vit: ≥ 2
- Numri mesatar i pjesëmarrësve për kurs: 15–20
- Numri i të rinjve që përfundojnë me sukses dhe pajisen me certifikatë: ≥ 25
- Raporti vjetor i përgatitur dhe dorëzuar: 1 raport në vit

Masa 5. Ngritja dhe funksionimi i një sistemi vendor për referimin dhe ndjekjen e rasteve në nevojë, për të gjitha grupet vulnerabël në territorin e bashkisë.

Aktivitete

- ✓ A 5.1 Hartimi i protokolleve të bashkëpunimit
- ✓ A 5.2 Trajnimi i NjVRN
- ✓

Treguesit

- Sistemi i ngritur dhe funksional
- 3 marrëveshje bashkëpunimi
- 30 raste të trajtuara në vit

PRIORITETI 2 – Edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për të drejtat sociale, mbrojtjen e fëmijëve dhe përfshirjen e të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara në jetën komunitare.

Objektivi Specifik: Të rritet ndërgjegjësimi dhe edukimi qytetar për të drejtat sociale, përfshirjen dhe mbështetjen ndaj grupeve vulnerabël në Bashkinë Delvinë.

Masa 1 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit për mbrojtjen e fëmijëve, PAK dhe të moshuarve.

Aktivitete

- ✓ A 1.1 Hartimi i një kalendari vjetor të fushatave.
- ✓ A 1.2 Zbatimi i fushatave në bashkëpunim me shkollat, OJF-të dhe median.
- ✓ A 1.3 Shpërndarja e materialeve informuese dhe mesazheve sensibilizuese.

Tregues

- 3 fushata sensibilizuese në vit.
- Të paktën 15 shkolla dhe 3 OJF të përfshira.
- 500 fëmije dhe të rritur, qytetarë të bashkisë, të kontaktuar direkt ose përmes mediave.

Masa 2 Zhvillimi i aktiviteteve edukative për të rinjtë dhe komunitetin mbi barazinë sociale, të drejtat e njeriut. mosdiskriminim

Aktivitete

- ✓ A 2.1 Realizimi i takimeve edukative në shkolla dhe komunitet.
- ✓ A 2.2 Përfshirja e të rinjve në debate, ekspozita dhe ditë ndërgjegjësimi.

Tregues

- 45 aktivitete edukative në vit. (15 aktivitete për të drejtat e njeriut dhe fëmijes, 15 aktivitete për dhunen, 15 aktivitete për angazhimin dhe përfshirjen në vendimmarrje,)
- 300 të rinj të përfshirë..

Masa 3 Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informuese mbi të drejtat dhe shërbimet sociale.

Aktivitete

- ✓ A 3.1 Hartimi i broshurave, posterave dhe spoteve informuese.
- ✓ A 3.2 Publikimi përmes rrjeteve sociale, mediave lokale dhe qendrave komunitare.
- ✓ A 3.3 Përhapja në shkolla, qendra shëndetësore dhe në takime komunitare.

Tregues

- 3 materiale informuese të përgatitura në vit.
- Min. 1000 kopje të shpërndara.
- 10 pika shpërndarjeje në territorin e bashkisë.

PRIORITETI 3 – Rritja e kapaciteteve institucionale për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale në një bashki me burime të kufizuara.

Objektivi Specifik: Të forcohet kapaciteti institucional i Bashkisë Delvinë për planifikimin, menaxhimin dhe ofrimin efektiv të shërbimeve sociale për grupet në nevojë.

Masa 1 Riorganizimi i strukturës së shërbimeve sociale dhe ngritja e NjVRN

Aktivitete

- ✓ A 1.1 Hartimi dhe miratimi i një strukture të re organizative që përfshin një Sektor të dedikuar për shërbimet sociale të drejtuar nga një përgjegjës dhe Njësinë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NjVRN).
- ✓ A 1.2 Hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme për funksionimin e sektorit dhe NjVRN.
- ✓ A 1.3 Emërimi i përgjegjësit të sektorit
- ✓ A 1.4 Rekrutimi /caktimi i stafit të posaçëm për NjVRN
- ✓ A 1.5 Fillimi i funksionimit të NJVRN.

Tregues

- 1 strukturë e re e miratuar dhe funksionale.

- 1 rregullore e brendshme e rishikuar, miratuar nga keshilli bashkiak dhe funksionale..
- 1 person emeruar pergjegjes I sektorit per ceshjet sociale
- Të paktën 1 person i rekrutuar per NJVRN.
- NJVRN funksionon normalisht

Masa 2 Rritja e kapaciteteve te stafit te sektorit te riorganizuar dhe NJVRN.

Aktivitete

- ✓ A 2.1 Realizimi i 6 trajnimeve (2 trajnime ne vit x 3 vite)

Tregues

- Të paktën 6 module të hartuara.
- 6 trajnime të realizuara
- Të paktën 15 punonjës të trajnuar çdo vit.

Masa 3 Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me shoqërinë civile

Aktivitete

- ✓ A 3.1 Organizimi i takimeve koordinuese me institucionet rajonale, OJF-të dhe operatorët e shërbimeve.
- ✓ A 3.2 Formalizimi i bashkëpunimit përmes marrëveshjeve dhe memorandumëve.
- ✓ A 3.3 Zbatimi i nismave të përbashkëta për fushata informuese, ndihmë emergjente dhe mbështetje për grupet vulnerabël.

Tregues

- Të paktën 3 marrëveshje bashkëpunimi të reja të nënshkruara në vit.
- Të paktën 3 aktivitete të përbashkëta të realizuara çdo vit.
- 1 rrjet informal funksional për koordinimin lokal.
- Rritje e pjesëmarrjes së OJF-ve dhe aktorëve në proceset vendimmarrëse sociale.

Masa 4 Përthithja e fondeve shtetërore dhe nga donatorët për zhvillimin e shërbimeve sociale në nivel vendor.

- ✓ 4.1 Monitorimi i thirrjeve për aplikime nga fondet shtetërore, IPARD, IPA, donatorë të huaj.
- ✓ 4.2 Hartimi i projekt-propozimeve në bashkëpunim me aktorë të tjerë.
- ✓ 4.3 Ndjekja e zbatimit, raportimit dhe vlerësimit të projekteve të fituara.

Tregues

- Të paktën 3 aplikime në vit për fonde kombëtare ose ndërkombëtare.
- Të paktën 1 projekt i financuar dhe në zbatim çdo vit.
- Raporte të rregullta për çdo projekt të mbështetur.

- Rritje graduale e portofolit financiar të shërbimeve sociale me fonde të jashtme (të matur çdo vit).

PRIORITETI 4 – Zhvillimi i mekanizmave të monitorimit dhe grumbullimit të të dhënave për grupet në nevojë

Objektivi Specifik:

Të krijohet një sistem funksional dhe i qëndrueshëm për grumbullimin, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave sociale në nivel vendor, që mundëson planifikim të bazuar në evidenca, identifikim të hershëm të rasteve dhe rritje të transparencës në ndërhyrje për grupet në nevojë.

Masa 1: Ngritja e një baze të dhënash sociale për grupet në nevojë

Aktivitet

- ✓ A 1.1 Hartimi i konceptit teknik për bazën e të dhënave (kategoritë, indikatorët, strukturimi).
- ✓ A 1.2 Pajisja me softuer të përshtatshëm për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave.
- ✓ A 1.3 Trajnimi i stafit të sektorit social për përdorimin e sistemit.
- ✓ A 1.4 Mbledhja dhe futja graduale e të dhënave për grupet në nevojë (fëmijë, PAK, të moshuar, viktime dhune, etj.).

Treguesit

- 1 koncept teknik i miratuar për bazën e të dhënave.
- 1 sistem funksional elektronik i instaluar dhe operativ.
- Të paktën 4 punonjës të trajnuar për përdorimin e sistemit.
- Të paktën 5 kategori të grupeve në nevojë të përfshira në databazë.
- Të dhënat bazë për të paktën 300 individë të grumbulluara brenda vitit të parë.

Masa 2: Monitorimi periodik dhe analizimi i të dhënave për planifikim dhe vendimmarrje

Aktivitete

- ✓ A 2.1 Hartimi i një kalendar vjetor për monitorimin dhe përditësimin e të dhënave.
- ✓ A 2.2 Përgatitja e raporteve periodike analitike mbi situatën e grupeve në nevojë.
- ✓ A 2.3 Integrimi i të dhënave në proceset e hartimit të buxhetit dhe planeve të ndërhyrjes sociale.
- ✓ A 2.4 Organizimi i tryezave me aktorët lokalë për prezantimin e gjetjeve dhe reflektimin në politikat sociale.

Treguesit

- 1 kalendar vjetor i miratuar për përditësimin dhe raportimin e të dhënave.
- Të paktën 2 raporte analitike të hartuara në vit.

- Të paktën 1 rekomandim për politikë sociale i mbështetur në të dhëna, i integruar në vendimmarrje.
- Të paktën 1 takim në vit me aktorët lokalë për diskutimin e gjetjeve.

Masa 3: Garantimi i sigurisë, etikës dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Aktivitete

- ✓ A 3.1 Hartimi i protokolleve të mbrojtjes së të dhënave në përputhje me legjislacionin.
- ✓ A 3.2 Trajnim i stafit për ruajtjen e konfidencialitetit dhe përdorimin etik të të dhënave.

Treguesit

- 1 protokoll sigurie dhe etike i miratuar dhe zbatuar.
- Të paktën 1 trajnim në vit për stafin mbi mbrojtjen e të dhënave.
- 1 raport vjetor i auditimit të sistemit të të dhënave.
- Zero shkelje të raportuara mbi përdorimin e të dhënave personale.

Per realizimin e objektivave të Planit Social Vendor nevojiten 38,110,600 lekë në total, nga të cilat 13,431,600 lekë përballohen nga bashkia dhe 24,679,000 leke do të negociohen me donator, OJF, partner të tjerë.

Prioriteti	Total	Bashkia	Donartor i pambuluar
P1	28,264,000	5,205,000	23,059,000
P2	3,988,200	3,688,200	300,000
P3	4,989,600	4,089,600	900,000
P4	868,800	448,800	420,000
Total	38,110,600	13,431,600	24,679,000

PLANI I VEPRIMIT

PRIORITETI 1 – Zhvillimi dhe diversifikimi i shërbimeve sociale për grupet më të cenueshme, me fokus tek të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në konflikt me ligjin.							
Objektivat	Aktiviteti	Indikatori	Afati i zbatimit		Buxheti dhe burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/Sektor/Departamenti(Udheheqes)	Institucion kontribues (nëse ka)
Objektivi specifik 1 (OS1): Të sigurohet ofrimi i shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në konflikt me ligjin, në të gjithë territorin e Bashkisë Delvinë, përmes zgjerimit të formateve të shërbimit, përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese dhe ngritjes së kapaciteteve vendore.							
1. Krijimi i shërbimeve të lëvizshme dhe në familje për të moshuarit dhe PAK.	1.1 Hartimi i një plani për shërbimet e lëvizshme	Plani i shërbimeve i miratuar	2025	2025	44,000 lek/Bashkia me fondet e veta	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF

	1.2 Trajnimi i stafit për ofrimin e shërbimeve në terren	2 module hartuara	2025	2026	150,000 leke/Donator I pambulluar	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
		5 punonjës të trajnuar	2026	2026	90,000 leke/donator I pambulluar	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	1.3 Pilotimi i shërbimeve në njësitë më të largëta të bashkisë.	2 zona të mbuluara me shërbime 30 përfitues (PAK dhe të moshuar) përfitues të shërbimeve lëvizëse	2026	2028	19,000,000 leke Donator I pambulluar	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
2. Riorganizimi i qendrës ekzistuese për moshën e tretë në qendër multifunksionale.	2.1 Hartimi i projektit teknik për ristrukturimin.	Projekti i riorganizimit përfunduar	2025	2025	44,000 lek/Bashkia me fondet e veta	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	2.2 Pajisja e qendrës me infrastrukturën për PAK.	Qendra përdoret nga më shumë se 2 grupe ne nevoje (te moshuar dhe PAK)	2026	2026	500,000 leke/Bashkia me fondet e veta	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF

	2.3 Zgjerimi i shërbimeve për përfitues të rinj (PAK, të rinj në nevojë).	10 përfitues të rinj në vit	2026	2028	4,617,000 leke /Bashkia me fondet e veta 3,069,000 lek/Donator I pambuluar	Spektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
3. Programe mbështetëse për fëmijët në konflikt me ligjin dhe familjet e tyre	3.1 Hartimi i një programi edukativ dhe rehabilitues	Programi I hartuar dhe funksional	2026	2026	150,000 leke/Donator I pambuluar	Spektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit/PMF	OJF
	3.2 Bashkëpunim me familjen, shkollën dhe qendrën sociale	17 fëmijë të përfshirë	2026	2028	Pa kosto	Spektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	3.3 Aktivitetet me fokus përfshirjen dhe mbështetjen e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe familjet e tyre	4 aktivitet në vit Tre raport vjetorë të hartuara	2026	2028	Pa kosto	Spektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit/PMF	OJF

4. Zbatimi i programeve të aftësisit profesional për të rinjtë përmes kurseve dixhitale që ofrohen në Qendrën Multifunktionale për Shërbimet Sociale.	4.1 Identifikimi dhe përfshirja e të rinjve në programin e trajnimit, me fokus te ata në situatë vulnerabël.	Numri i të rinjve të përfshirë në program gjatë vitit: ≥ 30	2026	2028	Pa kosto	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit/PMF	OJF
	4.2 Zhvillimi i kurseve dixhitale në ambientet e Qendrës Multifunktionale, sipas programeve dhe	Përqindja e të rinjve nga grupe vulnerabël: ≥ 50%	2026	2028	Pa kosto	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit/PMF	OJF
		Numri i kurseve të realizuara në vit: ≥ 2					
	Numri mesatar i pjesëmarrësve për kurs: 15–20						
5. Ngritja dhe funksionimi i një sistemi vendor për referimin dhe ndjekjen e rasteve në nevojë, për të gjitha grupet vulnerabël në territorin e bashkisë.	5.1 Hartimi i protokolleve të bashkëpunimit	Sistemi i ngritur dhe funksional 8 protokolle të hartuara dhe të miratuara	2026	2027	480,000 leke/Donator I pambulluar	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF

Objektivi Specifik: Të rritet ndërgjegjësimit dhe edukimi qytetar për të drejtat sociale, përfshirjen dhe mbështetjen ndaj grupeve vulnerabël në Bashkinë Delvinë.

Masa 1 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit për mbrojtjen e fëmijëve, PAK dhe të moshuarve.	1.1 Hartimi i një kalendari vjetor të fushatave.	3 kalendare vjetore të hartuara	2026	2028	79,200 leke/Bashkia me fondet e veta	Sektori i Sherbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	1.2 Zbatimi i fushatave në bashkëpunim me shkollat, OJF-të dhe median.	3 fushata sensibilizuese në vit. Të paktën 15 shkolla dhe 3 OJF të përfshira në fushata në vot	2026	2028	792,000 leke/Bashkia me fondet e veta	Sektori i Sherbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	1.3 Shpërndarja e materialeve informuese dhe mesazheve sensibilizuese.	500 materiale të prodhuara dhe shpërndarë, 500 fëmijë dhe të rritur, qytetarë të bashkise, të kontaktuar direkt ose përmes mediave.	2026	2026	45,000 lek/Bashkia me fondet e veta	Sektori i Sherbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
Masa 2 Zhvillimi i aktiviteteve edukative për të rinjtë dhe komunitetin mbi barazinë sociale, të drejtat e njeriut. mosdiskriminim	2.1 Realizimi i takimeve edukative në shkolla dhe komunitet.	45 aktivitete edukative në vit. (15 aktivitete për të drejtat e njeriut dhe fëmijes, 15 aktivitete për dhunen, 15 aktivitete për angazhimin dhe përfshirjen në vendimmarrje,)	2026	2028	2,376,600 leke /Bashkia me fondet e veta	Sektori i Sherbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF

	2.2Përfshirja e të rinjve në aktivitete	150 të rinj të përfshirë..					
Masa 3 Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informuese mbi të drejtat dhe shërbimet sociale.	3.1 Hartimi i broshurave, posterave dhe spoteve informuese.	3 materiale informuese të përgatitura në vit.	2026	2028	396,000 leke /Bashkia me fondet e veta	Spektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	3.2 Publikimi përmes rrjeteve sociale, mediave lokale dhe qendrave komunitare.	Min. 1000 kopje të shpërndara.	2026	2028	300,000 leke/Dona tor I pambuluar	Spektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	3.3 Përhapja në shkolla, qendra shëndetësore dhe në takime komunitare.	10 pika shpërndarjeje në territorin e bashkisë.					
Totali					3,988,200		

PRIORITETI 3 – Rritja e kapaciteteve institucionale për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale në një bashki me burime të kufizuara

Objektivat	Aktiviteti	Indikatori	Afati i zbatimit		Buxheti dhe burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/S ektori/Departamenti(Udheheqes)	Institucion kontribues (nese ka)
Objektivi specifik 1 (OS1): Të forcohet kapaciteti institucional i Bashkisë Delvinë për planifikimin, menaxhimin dhe ofrimin efektiv të shërbimeve sociale për grupet në nevojë.							
Masa 1 Riorganizimi i strukturës së shërbimeve sociale dhe ngritja e NjVRN	1.1 Hartimi dhe miratimi i një strukture të re organizative që përfshin një Sektor të dedikuar për shërbimet sociale të drejtuar nga një përgjegjës dhe Njësinë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NjVRN).	1 strukturë e re e miratuar dhe funksionale.	2025	2025	Pa kosto	Sektori i Sherbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	1.2 Hartimi dhe miratimi i rregullore së brendshme për funksionimin e sektorit dhe NjVRN.	1 rregullore e brendshme e rishikuar, miratuar nga keshilli bashkiak dhe funksionale.	2025	2026	Pa kosto	Sektori i Sherbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF

	1.3 Emërimi i përgjegjës të sektorit	1 person emëruar përgjegjes I sektorit për ceshjet sociale	2026	2027	Pa kosto	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	
	1.4 Rekrutimi /caktimi i stafit të posaçëm për NJVRN	1 person i rekrutuar	2026	2026	Pa kosto	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	
	1.5 Fillimi i funksionimit të NJVRN	NJVRN funksionon normalisht	2026	2028	3,366,000 leke/Bashkia me fondet e veta	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
Masa 2 Rritja e kapaciteteve të stafit të sektorit të riorganizuar dhe NJVRN	2.1 Realizimi i 6 trajnimeve (2 trajnime ne vit x 3 vite)	6 module të realizuara (2 module ne vit)	2026	2028	450,000 leke /Donator I pambulluar	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
		6 Trajnime njëditore të realizuara (2 ne vit)	2026	2028	90,000 leke/Donator I pambulluar	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
		15 pjesmarres					

		ne cdo trajnim					
Masa 3 Rritja e kapaciteteve të stafit të shërbimeve sociale përmes trajnimeve dhe asistencës teknike për përballimin e situatave të emergjences (natyrore, shendetesore etj)	3.1 Hartimi i një protokollit për ofrimin e shërbimeve shoqerore ne kushte te emergjencave	1 program trajnimi i hartuar dhe zbatuar çdo vit.	2026	2026	105,600 leke /Bashkia me fondet e veta	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	3.2 Zhvillimi i trajnimeve për njohjen dhe përdorimin e protokollit	Të paktën 4 module të hartuara.	2026	2027	300,000 leke /Donator I pambulluar	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
		4 Trajnime nje ditore te realizuara 10 punonjes marrin pjese ne trajnime	2026	2027	60,000 leke/Donator I pambulluar	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	3.3 Stimulime te ofrimit te shërbimeve shoqerore ne kushte emergjence	3 stimulime te realizuara	2026	2028	90,000 leke/Donator I pambulluar	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
Masa 4 Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional dhe me shoqërinë civile	4.1 Organizimi i takimeve koordinuese me institucionet rajonale, OJF-të dhe operatorët e shërbimeve.	Të paktën 2 aktivitete të përbashkëta të realizuara çdo vit.	2026	2028	264,000 leke/Bashkia me fondet e veta	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF

		Të paktën 2 marrëveshje bashkëpunimi të reja të nënshkruara në vit.	2026	2028	264,000 leke/Bashkia me fondet e veta	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	4.2 Formalizimi i bashkëpunimit përmes marrëveshjeve dhe memorandumeve.	1 rrjet informal funksional për koordinimin lokal.	2025	2026	Pa kosto	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	4.3 Zbatimi i nismave të përbashkëta për fushata informuese, ndihmë emergjente dhe mbështetje për grupet vulnerabël.	3 nisma të përbashkëta të realizuara	2026	2028	Pa kosto	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
Masa 5 Përthithja e fondeve shtetërore dhe nga donatorët për zhvillimin e shërbimeve sociale në nivel vendor.	5.1 Monitorimi i thirrjeve për aplikime nga fondet shtetërore, IPARD, IPA, donatorë të huaj.	3 thirrje për financim të identifikuar dhe të dokumentuar	2026	2028	Pa kosto	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	5.2 Hartimi i projekt-propozimeve në bashkëpunim me aktorë të tjerë.	Të paktën 2 aplikime në vit për fonde kombëtare ose	2026	2028	Pa kosto	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF

		ndërkombëtare.					
	5.3 Ndjekja e zbatimit, raportimit dhe vlerësimit të projekteve të fituara..	Raporte të rregullta për çdo projekt të mbështetur.	2026	2028	Pa kosto	Sektori i Shërbimeve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	Totali				4,899,600		

PRIORITETI 4 – Zhvillimi i mekanizmave të monitorimit dhe grumbullimit të të dhënave për grupet në nevojë

Objektivat	Aktiviteti	Treguesi	Afati i zbatimit		Buxheti dhe burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria /Sektori/ Departamenti(U dheheqes)	Institucion kontribuues (nese ka)
Objektivi specifik 1 (OS1): Të krijohet një sistem funksional dhe i qëndrueshëm për grumbullimin, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave sociale në nivel vendor, që mundëson planifikim të bazuar në evidenca, identifikim të hershëm të rasteve dhe rritje të transparencës në ndërhyrje për grupet në nevojë							

Masa 1 Ngritja e një baze të dhënash sociale për grupet në nevojë	1.1 Hartimi i konceptit teknik për bazën e të dhënave (kategoritë, indikatorët, strukturimi).	1 koncept teknik i miratuar për bazën e të dhënave.	2027	2027	44,000 leke /Bashkia me fondet e veta	Sektori i Sherbim eve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	1.2 Pajisja me softuer të përshtatshëm për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave.	1 sistem funksional elektronik i instaluar dhe operativ.	2027	2027	150,000 leke/Dona tor I pambuluar	Sektori i Sherbim eve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	1.3 Trajnimi i stafit të sektorit social për përdorimin e sistemit.	Të paktën 4 punonjës të trajnuar për përdorimin e sistemit.	2027	2027	60,000 leke/Dona tor I pambuluar	Sektori i Sherbim eve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	1.4 Mbledhja dhe futja graduale e të dhënave për grupet në nevojë (fëmijë, PAK, të moshuar, viktima dhune, etj.).	Të paktën 5 kategori të grupeve në nevojë të përfshira në databazë. Të dhënat bazë për të paktën 300 individë të grumbulluara brenda vitit të parë.	2027	2028	Pa kosto	Sektori i Sherbim eve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF

Masa 2: Monitorimi periodik dhe analizimi i të dhënave për planifikim dhe vendimmarrje	2.1 Hartimi i një kalendar vjetor për monitorimin dhe përditësimin e të dhënave.	1 kalendar vjetor i miratuar për përditësimin dhe raportimin e të dhënave.	2027	2028	52,800 leke/Bashkia me fondet e veta	Sektori i Sherbimëve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	2.2 Përgatitja e raporteve periodike analitike mbi situatën e grupeve në nevojë.	Të paktën 2 raporte analitike të hartuara në vit.	2027	2028	176,000 leke/bashkia me fondet e veta	Sektori i Sherbimëve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	2.3 Integrimi i të dhënave në proceset e hartimit të buxhetit dhe planeve të ndërhyrjes sociale.	Të paktën 1 rekomandim për politikë sociale i mbështetur në të dhëna, i integruar në vendimmarrje.	2027	2028	Pa kosto	Sektori i Sherbimëve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	2.4 Organizimi i tryezave me aktorët lokalë për prezantimin e gjetjeve dhe reflektimin në politikat sociale.	Të paktën 1 takim në vit me aktorët lokalë për diskutimin e gjetjeve.	2027	2028	176,000 leke/bashkia me fondet e veta	Sektori i Sherbimëve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF

Masa 3: Garantimi i sigurisë, etikës dhe mbrojtjes së të dhënave personale	A 3.1 Hartimi i protokolleve të mbrojtjes së të dhënave në përputhje me legjislacionin.	1 protokoll sigurie dhe etike i miratuar dhe zbatuar.	2027	2027	150,000 leke/Dona tor I pambuluar	Sektori i Sherbim eve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	3.2 Trajnim i stafit për ruajtjen e konfidencialitetit dhe përdorimin etik të të dhënave.	Të paktën 1 trajnim në vit për stafin mbi mbrojtjen e të dhënave.	2027	2028	60,000 leke/Dona tor I pambuluar	Sektori i Sherbim eve sociale, strehimit dhe arsimit	OJF
	Total				868,800		

VII. Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi dhe vlerësimi përbëjnë një komponent thelbësor të Planit Social Vendor të Bashkisë Delvinë 2025–2028, duke siguruar zbatimin e qëndrueshëm dhe të qëllimshëm të masave të parashikuara. Kjo fazë mundëson ndjekjen sistematike të progresit të arritur, identifikimin e sfidave dhe përshtatjen në kohë të ndërhyrjeve për të garantuar që rezultatet e synuara të arrihen në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

Struktura përgjegjëse për monitorimin do të jetë Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, në bashkëpunim të ngushtë me Njësinë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NjVRN). Do të krijohet një mekanizëm i përhershëm i brendshëm i monitorimit, ku do të angazhohen aktorë vendorë dhe përfaqësues të grupeve në nevojë për të rritur llogaridhënien dhe transparencën.

Procesi i monitorimit do të realizohet në mënyrë periodike përmes:

- Mbledhjes së të dhënave mbi zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e treguesve.
- Hartimit të raporteve vjetore për progresin e Planit.
- Përdorimit të indikatorëve të matshëm të përfshirë në planin e veprimit.
- Tryezave të përbashkëta me aktorë lokalë për analizimin e progresit dhe përcaktimin e masave korrigjuese.

Për vlerësimin do të përdoren tregues të burimeve, rezultateve dhe ndikimit për të matur përmbushjen e objektivave. Do të realizohen vlerësime vjetore të zbatimit të Planit, të cilat do të shërbejnë si bazë për rekomandime për politikat sociale vendore dhe hartimin e planeve të ardhshme.

Gjithashtu, Bashkia do të synojë përfshirjen e aktorëve të jashtëm në vlerësimin përfundimtar për të garantuar një analizë të paanshme, me standarde profesionale dhe të krahasueshme me praktikën më të mira në nivel vendor dhe kombëtar.

Përmes këtij sistemi monitorimi dhe vlerësimi, Bashkia Delvinë synon jo vetëm matjen e performancës, por edhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve sociale, duke e kthyer Planin në një mjet aktiv të ndryshimit social në territorin e saj.

VIII Shtojca

Shtojca 1 Kuadri legjislativ

Plani Social Vendor hartohet në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Konventën për të Drejtat e Njeriut;
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar);
- Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale;
- Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH);
- Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- CEDAE

Dokumentet strategjike:

- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi;
- ✓ Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar;
- ✓ Dokumenti Politik – Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore;
- ✓ Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale.

Korniza e përgjithshme ligjore, mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social përbëhet nga:

- Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (FZ 20-1996).

Dokumente vendore:

- Strategjia Territoriale Bashkia DELVINË;
- Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia DELVINË.

Shtojca 2 Persona burimorë dhe profesionistë lokale për mbrojtjen sociale në nivel bashkie dhe njësisish administrative

Grafiku paraqet rrjetin e aktorëve institucionalë dhe komunitarë që mbështesin kategoritë në nevojë në nivel lagje/fshat, bashkie dhe qarku. Ai shërben si mjet orientues për profesionistët e shërbimeve sociale, duke i ndihmuar të përdorin në mënyrë efektive burimet ekzistuese për parandalimin, referimin dhe mbështetjen e rasteve vulnerabël..

Rrathët koncentrikë përfaqësojnë nivelet e ndërhyrjes: i) Rrethi i brendshëm: niveli lokal/komunitar; ii) Rrethi i mesëm: niveli bashkiak; iii) Rrethi i jashtëm: niveli rajonal dhe kombëtar. **Ngjyrat** tregojnë institucionet dhe aktorët komunitarë përkatës, të cilët janë të pranishëm në nivele të ndryshme. Aktorët me të njëjtën ngjyrë përfaqësojnë të njëjtin institucion apo funksion në formatin e tij lokal, bashkiak dhe rajonal.

IX ANEKSE

ANEKSI 1

Nevoja e Identifikuar	Lloji i Ndërhyrjes
Mbingarkesa e funksioneve të një person për dhunën dhe mbrojtjen e fëmijëve	Ndarja e pozicioneve me punonjës të dedikuar
Mungesa e specialistit për kategori të tjera në nevojë	Shtimi i një punonjësi social me profil të dedikuar
Mungesa e Njesisë për Vlerësim dhe Referim të Nevojave	Ngritja dhe funksionalizimi i strukturës
Mungesa e harmonizimit të emërtesave me funksionet ligjore të administratorëve	Rishikimi i strukturës dhe përditësimi i titujve
Mungesa e bashkëpunimit të formalizuar me shërbimet e deleguara	Hartimi i një protokollit bashkëpunimi